



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1379 Prot.

Lezhë, më 02 . 02 . 2022

**VENDIM**

Nr. 2 Datë 01 . 02 . 2022

**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR  
NDIHMËN EKONOMIKE (FONDI 6 %) PËR VITIN 2022”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” si dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe VKM nr. 868 datë 29.12.2021 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**VENDOSI:**

Të miratohen kriteret e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike si më poshtë:

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar muajin e fundit nëpërmjet Regjistrimit Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit me arsyen: Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme.
2. Për të gjitha familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas këtij fondi, duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social - ekonomik në familje nga administratori shoqëror sipas shtojcës 2 të VKM nr.597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
3. Gjatë periudhës së trajtimit me fondin deri në 6 % , nëse verifikon që ka ndryshime të situatën social ekonomike, administratori shoqëror, referon familjen për të aplikuar në Regjistrimin Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike apo ndërpret periudhën e përfitimit në rast të punësimit të anëtarëve të familjes.
4. Masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese nga ky fond llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përlllogaritjes së masës së strukturës së familjes, për familjet përfituese të ndihmës

ekonomike (referuar edhe ndryshimeve të parashikuara nga VKM nr. 868 datë 29.12.2021 të lartpërmendur).

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**

**ERNEST RAKAJ**

